



**UNI – Universum International College DORACAK
APLIKIMI PER SHKËMBIM TË STAFIT**

Programi Erasmus+

Programi Erasmus+ është program i Bashkimit Evropian që mbështetë në fushën e arsimit, trajnime, rininë dhe sportin, në Evropë dhe shtetet partnere. Programi Erasmus+ është i ndarë në disa sektorë apo nën-programe.

Programi Erasmus+ financohet nga Komisioni Evropian me participim buxhetor të shteteve të programit. Shtetet e programit janë: të gjitha shtetet anëtare të BE-së (Turqia, Norvegjia, Islanda, Maqedonia e Veriut dhe nga viti 2019 edhe Serbia).

Universitetet nga këto shtete kanë qasje të plotë në fonde të programit Erasmus+ në të gjitha projektet.

Kosova, që nga viti 2015 është shtet partner në programin Erasmus+ dhe ka qasje të limituar në projekte të caktuara si Kordinator apo si partner. Kosova, hyn në kategorinë Region i Western Balkans bashkë me Shqipërinë, Malin e Zi, Bosnie dhe Hercegovinën.

UNI-Universum, që nga 2015/2016 është përfitues i disa projekteve/sectorëve të programit Erasmus+. Kolegji Universum është Institucioni i parë i Arsimit të Lartë pjesë e programit Erasmus+ dhe mbetet lider për projektet e Erasmus+ në Kosovë.

Duke filluar nga viti 2023, UNI-Universum ka fituar akreditimin nga Komisioni Evropian dhe tani njihet si pjesë e listës së Erasmus Charter.

Cfarë është Erasmus Charter?

Erasmus Charter apo Karta Erasmus për Arsimin e Lartë (ECHE) është një certifikatë e lëshuar nga Komisioni Evropian për institucionet e arsimit të lartë, duke i lejuar ato të marrin pjesë në programin Erasmus+. Ai nënkupton përkushtimin e një institucioni për cilësinë dhe ndërkombëtarizimin në arsimin e lartë dhe u mundëson atyre të angazhohen në aktivitete si student mobility dhe staff mobility dhe projektet e bashkëpunimit brenda kornizës Erasmus+.



Projektet e programit Erasmus+ që UNI- Universum është përfitues:

- Erasmus + K107 International Credit – objektivi kryesor I këtij projekti është të mundësojë shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik dhe administrative me univeristetet partnere të shteteve te programit te BE-së. Përmes këtij projekti UNI–Universum International College ka shkëmbyer mbi 55 studentë në 152 universitete në 26 shtete të BE-së dhe Turqisë. Bursa për cdo student është 800–900-euro kompenzim mujor dhe 275–360-euro komepnzim për shpenzime të transportit.
- 
- Erasmus+ K2 Capacity building in Higer Education – është project që ka për qëllim zhvillimin dhe modernizimin e kurrikulave, teknologjisë dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore të universiteteve partnere nga përvoja e shteteve të programit, pra shtete të Evropës. Këto projekte implementohen në konsorcium me 11 universitete partnere dhe implementimi zgjatë 2-3 vite me buxhet mbi 1 milion euro.
 - Strategic Partnership in Higher Education – ky project ka për qellim zhvillimin e kurrikulave në universitetet e shteteve partnere në bashkëpunim me universitetet e shteteve të BE-së.
 - Strategic Partnership in Youth – objektivi e këtij projekti është zhvillimi I aktiviteteve dhe nërtimi I kapaciteteve njerëzore në sektorin e artit, kulturës dhe sektorët kreativ.

Erasmus+ K107 SHKËMBIMI I STAFIT AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

Në kuadër të programit Erasmus+107 International Credit Mobility ofrohen mundësi që stafi i institucioneve arsimore të marrë një përvojë akademike ose profesionale në një vend tjetër në shtetet e Evropës.

Ky program mbështet zhvillimin profesional të stafit akademik dhe stafit administrative të UNI – Universum International College në formën e ngjarjeve trajnuese jashtë vendit.

Me Erasmus+ 107 mundësitë e trajnimit janë në dispozicion për të gjithë stafin e UNI – Universum International College në univeritetet partnere.

Lista e plotë e universiteteve partnere mund të gjindet në linkun më poshtë:

<https://www.universum-ks.org/bursa-nderkombetare/>



KATEGORITË E SHKËMBIMIT

Kohëzgjatja minimale për një Mobility Staff me këtë program është minimum 5 ditë pune + 2 ditë të udhëtimit. Granti aplikohet për 6-7 ditë duke përfshirë edhe ditët e udhëtimit.

STA (Staff Mobility for Teaching) – stafi akademik i UNI – Universum International College ka mundësinë të ligjërtojë në universitetin pritës deri në 8 orë akademike. Stafi akademik i UNI – International College do të ligjërtojë si ligjërues mysafirë i bartësit të lëndës që ka zgjedhur në universitetin që ka aplikuar.

Stafi i UNI – Universum International College pas përfundimit do të marrë Certifikatë për Ligjerim në lëndën apo departamentin e caktuar.

STT (Staff Mobility for Training) - stafi administrative dhe akademik do të njej trajnim specific, vizitë studimore, vizitë në separtamente specifike, zyre të ndryshme apo të ndjekë Javën Nërcombëtare të Erasmus+ (Erasmus+ Staff Eëek).

Shumica e universiteteve preferojnë pjesëmarrjen në Javën Ndërkombëtare.

PROCEDURAT DHE RREGULLAT E APLIKIMIT

1. Personeli i UNI – Uniersum International College duhet të plotësojë formularin e aplikimit <https://forms.gle/auo85tUAQkUZ1T7L6>
2. Zyra Ndërkombëtare e UNI- Universum International College njofton personelin rreth statusit të aplikimit, varësisht nga kohëzgjatje, universiteti dhe shteti ku ka aplikuar.
3. Zyra Ndërkombëtare nominon stafin tek Zyra Ndërkombëtare e universitetit pritës.
4. Personeli I UNI- Universum International College obligohet që cdo komunikim me UNI dhe me personelin e universitetit pritës të përdorë vetëm emailën zyrtare të UNI.
5. Personeli I UNI- Universum International College në cdo komunikim me universitetin pritës mban të informuar Zyrën Ndërkombëtare të UNI më konkretisht përmes emailës: erasmus@universum-ks.org
6. Personeli duhet të plotësojë Marrëveshjen e Mobilitetit (Mobility Agreement)
7. Personeli pranon Letren/Ftesën e pranimit nga universiteti pritës për aplikim për vizë.
8. Personeli nënshkruan Grant Agreement apo Marrëveshjen për Bursë me universitetin pritës, ku përcaktohen kushtet dhe mënyra e rimbursimit.
9. Transferimi I grantit apo bursës mund të kryhet para nisjes apo gjatë qëndrimit në universitetin pritës në llogarin bankare të stafit përfitues të specifikuar në Grant Agreement. Në disa raste, pas kthimit ne Kosovë.
10. Cdo universitet ka rregullat specifike për të cilat njoftohet stafi paraprakisht.
11. Personeli aplikon për vizë duke marrë me vete:
 1. Letrën e pranimit
 2. Marrëveshjen në mes të UNI- Universum International College dhe universitetit pritës
 3. Grant Agreement
 4. Mobility Agreementy
12. Personeli obligohet që para nisjes/ udhëtimit të lexojë Manualin per Mobilitet Ndërkombëtar ku specifikohen detajet e udhëtimit, për organizim të udhëtimit, normat kulturore të shtetit pritës etj.

13. Personeli obligohet që fatura e udhëtimit, akomodimit të jenë në emër të UNI – Universum International College me të dhënat:
Kolegji Universum,
Pristina, Kosovo
Fiscal number: 810640294
Faturat duhet të dërgohen në Zyrën e Financave në emailin : finance@universum-ks.org
14. Stafii përfitues obligohet të ruaj të gjitha dokumentet e udhëtimit si: Boarding Pass dhe faturë, varësisht nga kërkesa e universitetit pritës.

Aplikimet duhet të dorësohen mbrena afatave të përcaktuara për të cilat do të njoftoheni me kohë.

UNI – Universum International College dhe universiteti pritës janë të obliguar që t'i ndimojnë stafit përfitues në kompletimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme për realizimin e sukseshëm të shkëmbimit, për aplikim për vizë në rastin kur stafi përfitues ka kryer paraprakisht të gjitha obligimet e tyre të dala nga Kontrata për Marrëdhënie të Punës (në rastet kur një e tillë është e nënshkruar dhe në fuqi). Uni – Universu, Internatinal College po ashtu do të lehtësojë të gjithë procesin berenda hapësirave të mundshme, do të ndihmojë edhe në aplikim për vizë por aplikimi bëhet në mënyrë individuale nga stafi përfitues.

Gjatë Shkëmbimit – During Mobility

- **Respektimi i rregullave të shtetit dhe universitetit pritës.**
Gjatë trajnimit apo ligjërimit në universitetin pritës stafi përfitues është duke e përfaqësuar UNI – Universum. Andaj kërkohet që nga ata që të tregojnë cilësi dhe sjellje të larta etike dhe akademike, si vlera të mirëfillta personale dhe institucionale të UNI- Universum.
- Stafi përfitues obligohet të ruaj të gjitha dokumentet/dëshmitë raportuese të udhëtimit si:
 1. Boarding Pass
 2. Vulen e hyrjes në pasaportë që të dëshmojë në raportim tek univeriteti pritës.
- Promovimi I UNI – Universum International College
Stafi përfitues të cilët janë pjesë e shkëmbimeve ndërkombëtare duhet të shkruajnë një artikull të paktën 250 fjalë per Blogun e UNI-Universum, duke treguar për eksperiencën e tyre në universitetin mikëpritës dhe duke ju drejtuar palëve të interes për të treguar mundësitë e ofruara nga UNI-Universum.
- Gjatë trajnimit në universitetin pritës, stafi përfitues janë të obliguar që të postojnë së paku një herë në javë në rrjetet e tyre sociale mbi aktivitetet interesante që ata kalojnë gjatë kohës së tyre në shkëmbim dhe të dërgojnë fotografi dhe video nga eksperienca e tyre.
- Sjelljet të cilat janë rreptësisht të ndaluara për stafin e UNI-Universum Brenda Kosovës dhe gjatë shkëmbimit janë:
 1. Konsumimi I substancave ilegale
 2. Përfshirja në kampanja me karakter ekstremist, racist apo diskriminues
 3. Antarësimi apo pjesëmarrja në aktivitete terroriste
 4. Përfshirja apo pjesëmarrja në aktivitete tjera kriminale

Për stafin përfitues në shkëmbim është obligative respektimi I ligjeve dhe rregullave të vendit mikpritës.

Pas kthimit – After Mobility

- Stafi përfitues pas përfundimit të shkëmbimit, duhet të plotësojë Pyetësorin/Raportin nga EU Commission të dërguar direct në email-in konstakutes. Stafi duhet të tregojë për përvojën personale dhe kulturore gjatë shkëmbimit.
- Stafi përfitues obligohet të plotësojë Report Form të Zyrës Ndërkombëtare të UNI – Universum të cilin do e pranoni në email pasi që të ktheheni.
- Stafi pranon Certifikatë për pjesëmarrje nga universiteti pritës.

Rregullat Financiare

Aplikantët e suksesshëm marrin fonde për të mbështetur shkëmbimin e tyre.

Fondet e pranushme për Erasmus+ Mobiliteti i Trajnimit të Stafit përbëhen nga dy komponentë:

- Ndihma individuale (jetesës)
- Kompensimi i biletave të ushëtimit

Ndihma individuale ne bazë të shteteve:

Shteti pritës	Shuma (1-7 ditë)
Danimarka, Finlanda, Islanda, Irlanda, Lihtenshtajni, Luksemburgu, Norvegjia, Suedia, Mbretëria e Bashkuar	180 EURO/ditë
Austri, Belgjikë, Qipro, Gjermani, Greqi, Francë, Itali, Malta, Holanda, Portugalia, Spanja	160 EURO/ditë
Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Estonia, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Turqi, Republika e Maqedonisë së Veriut, Serbi	140 EURO/ditë

Kontributi i udhëtimit llogaritet duke përdorur një kalkulator të distancës së udhëtimit të mbështetur nga Komisioni Evropian. (http://ec.europa.eu/programmes/erasmusplus/tools/distance_en.htm)

Distanca llogaritet midis vendndodhjes fillestare dhe mbarimit të lëvizshmërisë në vija të drejta nga një vend në tjetrin. Kompensimi i udhëtimit (km) kompenzohet nga tarifa për distancë si më poshtë.

Përfituesit duhet të mbajë kartat e konviktit / biletat e trenave / biletat e tjera të udhëtimit të cilat duhet të dorëzohen së bashku me dokumentacionin e lëvizshmërisë.

<i>Distanca e udhëtimit</i>	<i>Shuma</i>
<i>Ndërmjetë 10 dhe 99 KM</i>	<i>20 EUR për person</i>
<i>Ndërmjetë 100 dhe 499 KM</i>	<i>180 EUR për person</i>
<i>Ndërmjetë 500 and 1999 KM</i>	<i>275 EUR për person</i>
<i>Ndërmjetë 2000 and 2999 KM</i>	<i>360 EUR për person</i>

Kriteret për aplikim

Staff mobility for Teaching

- Aplikuesi duhet të jetë anëtar I stafit dhe të ketë kontratë të lidhur me UNI – Universum.
- Aplikanti duhet të jetë i gatshëm të kontribojë në objektivat e përgjithshme të Erasmus+ dhe UNi – Universum
- Njohuria e Gjuhes Angleze (së paku niveli B2)
- Përputhja e programit të studimit/ligjërimit
- Aftësi të mira komunikimi
- Në rast se stafi shkon në ndonjë javë ndërkombëtare, duhet të ruaj kontakte me universitetet pjesëmarrëse jo partnere dhe të rekomandoj/reklamojë UNI- Universum si partner të ardhëm potencial.

Staff Mobility for Training

- Aplikuesi duhet të jetë anëtar I stafit dhe të ketë kontratë të lidhur me UNI – Universum.
- Aplikanti duhet të jetë i gatshëm të kontribojë në objektivat e përgjithshme të Erasmus+ dhe UNi – Universum
- Njohuria e Gjuhes Angleze (së paku niveli B1)
- Aftësi prezantimi
- Aftësi të mira komunikimi
- Në rast se stafi shkon në ndonjë javë ndërkombëtare, duhet të ruaj kontakte me universitetet pjesëmarrëse jo partnere dhe të rekomandoj/reklamojë UNI- Universum si partner të ardhëm potencial.

Rezultatet e pritura

Aktivitetet gjatë shkëmbimit orutet të japin rezultatet e mëposhtme:

- Kompetenca të përmirësuara, të lidhura me profilet profesionale
- Të kuptuarit më të gjërë të praktikave, politikave dhe sistemeve në arsim dhe trajnim në vendin pritës.
- Rritja e aftësisë për të shkaktuar ndryshime në drejtim të modernizimit dhe hapjes ndërkombëtare brenda UNI - Universum.
- Cilësi më e mirë e punës dhe veprimtarive të tyre në favor të studentëve dhe Stafit në përgjithësi të UNI- Universum.
- Mirëkuptim dhe reagim më i madh ndaj diversitetit shoqëror, gjuhësor dhe kulturor.
- Mundësi të rritura për zhvillim profesional dhe karrierë.
- Përmirësimi i gjuhëve të huaja.
- Rritja e motivimit dhe kënaqësisë në punën e tyre të përditshme
- Të zhvillojë marrëdhëniet me institucionin pritës, duke eksploruar mundësi për lëvizjen e studentëve, diskutimin e potencialit për projekte bashkëpunuese në të ardhmen etj
- Të ndërtojë marrëdhënie të mira me stafin e universitetit përfitues në realizimin e projekteve të tjera Erasmus+ apo projekteve të tjera.
- Të iniciojë projekte, bashkëpunime me universitete tjera partnere të universitetit pritës
- Të promovojë programet e UNI - Universum që të nxisë shkëmbimet e stafit dhe studentëve nga universiteti/shteti pritës në UNI - Universum.
- Aplikanti duhet të demonstrojë një angazhim për promovimin e programit ERASMUS + në studentë dhe staf të UNI – Universum.

Foto nga përvoja e stafit



Kriteret e perzgjedhjes

1. Respektimi i rregullores për Ndërkombëtarizim, Zhvillim profesional të stafit akademik e administrativ.
2. Përparësi u jepet anëtarëve të përhershëm të stafit dhe atyre që marrin pjesë në Programin e Trajnimit të Stafit Erasmus + për herë të pare.
3. Aplikimi Brenda afatit.
4. Sigurohuni që formulari i aplikimit të jetë plotësuar dhe nënshkruar siç duhet.
5. Miratimi i institucionit pritës.



PLOTËSIMI I MOBILITY AGREEMENT

Mobility Agreement for Teaching or Training e cila përcakton planin e mësimdhënies/trajnitimit që duhet të ndiqet dhe miratohet nga përfituesi, institucioni dërgues dhe institucioni pritës. Shih më poshtë shembullin.

Mobility Agreement

Staff Mobility For Training/Teaching

Planned period of the training activity: from *DATA E FILLIMIT* till *data e DATA E PERFUNDIMIT*

Duration (days) – excluding travel days: **5**

The Staff Member

Last name (s)	MBIEMRI	First name (s)	EMRI
Seniority	PERVOJA E PUNES	Nationality	SHTETESIA
Gender [Male/Female]	M/F	Academic year	20../20..
E-mail	EMAIL-A ZYRTARE NGA KOLEGJI UNIVERSUM		

The Sending Institution

Name	Universum College	Faculty/ Department	DEPARTAMENTI PERKATES
Erasmus code (if applicable)	PIC-952566773 OID-E10136756	Country/ Country code	KOSOVO,XK
Address	MAGJISTRALA PRISHTINE-FERIZAJ,14000	Contact person e-mail / phone	gentianaberisha@universum-ks.org erasmus@universum-ks.org
Contact person name and position	Gentiana Berisha Head of IRO/ERASMUS+ OFFICE		

Seniority: Junior (afro < 10 vjet pervoje), Intermediate (afro > 10 and < 20 vjet pervoje), Senior (afro > 20 vjet pervoje).

Nationality: Bazuar ne pasaporte.

The Receiving Institution / Enterprise

Name	UNIVERSITETI PRITES		
Erasmus code (if applicable)	KONTAKTONI ZYREN NDERKOMBTARE	Faculty/Department	DEPARTAMENTI PERSHTATES
Address	PERDORNI GOOGLE	Country/ Country code	SHTETI,KODI
Contact person, name and position	KONTAKTONI ZYREN NDERKOMBTARE	Contact person e-mail / phone	KONTAKTONI ZYREN NDERKOMBTARE
		Size of enterprise (if applicable)	<input type="checkbox"/> <250 employees <input type="checkbox"/> >250 employees

Section to be completed BEFORE THE MOBILITY

PROPOSED MOBILITY PROGRAMME

Language of training: **ENGLISH**

Overall objectives of the mobility:
Training activity to develop pedagogical and/or curriculum design skills: Yes <input type="checkbox"/> No <input type="checkbox"/>
Added value of the mobility (in the context of the modernisation and internationalisation strategies of the institutions involved):
Activities to be carried out:
Expected outcomes and impact (e.g. on the professional development of the staff member and on both institutions):